## KARTELË INFORMATIVE

**AL101049**

| | |
|---|---|
| **1. Emri i shërbimit** | *Përfitim nga Fondi i Ekonomisë Kreative i akorduar nga buxheti i shtetit* |
| **2. Cili është qëllimi i shërbimit?** | *Fondi i Ekonomisë Kreative është krijuar për të mbështetur Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e artizanatit. Qëllimi i grantit nuk është zëvendësimi i asaj që ndërmarrja do të financonte me burimet e saj, por t'i shtohet buxhetit të ndërmarrjes, duke shërbyer si një nxitje për NMV-të për të rritur konkurueshmërinë e tyre. Kjo Skemë Granti bën të mundur që NMV-të përfituese të arrijnë më shumë nga sa ato do të mund të arrinin vetëm me mjetet e tyre.* |
| **3. Çfarë ofron ky shërbim?** | *Zhvillimi i sektorit të artizanatit dhe zejtarisë në Shqipëri, duke krijuar një mjedis të favorshëm për aktivitete më të qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.*<br>*Në varësi të projektit konkurrues, të përgatitur nga aplikantët, skema mbulon 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara, por jo më shumë se 500.000 (pesëqindmijë) lekë, ndërkohë që pjesa tjetër financohet nga përfituesi i grantit (në këtë rast ndërmarrja shqiptare).* |
| **4. A jam përfitues?** | *Biznes i klasifikuar si mikro dhe i vogël sipas ligjit Nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", të ndryshuar, të cilat kanë si objekt të aktivitetit veprimtari që përfshihen në termin artizanat ose zejtari .*<br>*Biznes që prodhon në Shqipëri produkte, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit ose krijojnë vende të reja pune.* |

**5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?**

| Nr | Lloji | Dokumenti lëshohet nga: | Dorëzohet në sportel nga aplikanti? |
|---|---|---|---|
| 1 | *Certifikata e regjistrimit* | *Qendra Kombëtare e Biznesit* | Po |
| 2 | *Pasqyrat financiare të vitit të fundit të ndërmarrjes* | *Studio e licensuar* | *Po* |
| 3 | *Në rastet kur bilanci është negativ, ndërmarrja duhet të dorëzojë një vërtetim bankar që vërteton që ndërmarrja ka në llogari bankare një shumë të barabartë me buxhetin e projektit* | *Aplikanti* | *Po* |
| 4 | *Dokumenti i identifikimit, i njohur nga ligji, i personit që paraqet kërkesën në emër të subjektit* | *Aplikanti/ Personi i autorizuar* | *Po* |
| 5 | *Autorizimi që vërteton se personi i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të aplikuar dhe për të bërë deklarimet e kërkuara në emër të subjektit.* | *Personi i autorizuar* | |
| 6 | *Buxheti i projektit "i detajuar sipas zërave" dhe i shoqëruar me planin e biznesit respektiv* | *Aplikanti* | *Po* |
| 7 | *Evidenca për produktet e prodhuara ose që do të prodhohen.Evidenca për shërbimet e ofruara ose që do të ofrohen* | *Aplikanti* | *Po* |
| 8 | *Vërtetim tatimor* | *Drejtoria Rajonale e Tatimeve* | *Jo* |
| 9 | *Vërtetim i pagesës së sigurimeve shoqërore* | *Instituti i Sigurimeve Shoqërore* | *Jo* |
| 10 | *Ekstrakti historik* | *Qendra Kombëtare e Biznesit* | *Jo* |

**6. Ku mund të aplikoj?**

| Zyrat pritëse | Qyteti | Adresa | Orari |
|---|---|---|---|
| *Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve* | *Tiranë* | *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kryeministria, Kati III* | *E hënë- E enjte, ora: 8:00-16:30*<br>*E premte, ora: 8:00- 14:00* |

**7. A është ky shërbim online?**

| Niveli 1 | Niveli 2 | Niveli 3 | Niveli 4 |
|---|---|---|---|
| *Ofrohet informacion mbi shërbimin* | *Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit* | *Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online* | *Shërbimi ofrohet tërësisht online* |
| [ ] | [X] | [ ] | [ ] |

**8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?**

| Tarifa bazë | Tarifa shtesë | Tarifa Online | Mënyra e pagesës |
|---|---|---|---|
| *Shërbim pa pagesë* | | *Nuk ka* | |

| | |
|---|---|
| **9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?** | *Minimumi 1 muaj* |
| **10. Çfarë përfitoj?** | *Marrëveshje, e cila nënshkruhet midis aplikantit dhe institucionit dhe vërteton përfitimin e fondit* |
| **11. Ç'afat vlefshmërie ka?** | *Sipas afatit të përcaktuar në marrëveshje, në varësi të projektit për të cilin është aplikuar* |
| **12. Ku e marr?** | *Në sportele* [X] *Me postë* [ ] *E-albania* [ ] *Me e-mail* [ ] |
| **13. Cili është institucioni përgjegjës?** | *Agjencia Shqiptare e Zhvillimit te Investimeve (AIDA)* |

**14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?**

| Kontakto në: | Orari |
|---|---|
| *E- albania:e-albania.al*<br>*ADISA web: www.adisa.gov.al*<br>*ADISA email: Informacion@adisa.gov.al*<br>*AIDA web:aida.gov.al/ ; info@aida.gov.al*<br>*Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike:* **0800 0118** | *Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E Hënë- E Premte, ora 08:00-19:00* |

| | |
|---|---|
| **15. Nëse kam ankesë, si të veproj?** | *Në sportele* [X] *Me postë* [X] *Web-i i Institucionit* [ ] *Me e-mail* [X]<br>*Në platformën "Shqipëria që duam"*<br>*Link: www.shqiperiaqeduam.al* [X] |
| **16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?** | *Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 15, datë 11.01.2017 ?Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit).* |